**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E SHKALLË SË PARË TIRANË**
**Nr. 22438 / 7**

## VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 15 ~~Tetor~~ Nëntor 2003, unë ........................., gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Z. Emmanuel Papathnassiou dhe Z. Georgios Tzaidas në cilësinë e Administratorëve të Shoqërisë ELDA PETROLEUM ALBANIA SHPK, për depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm,

## KONSTATOVA SE:

Shoqëria ELDA PETROLEUM ALBANIA SHPK është person juridik i së drejtës shqiptare e regjistruar me Vendimin Nr. 22438, datë 15 dhjetor 1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe ka për Ortak të Vetëm shoqërinë GLOBAL PETROLEUM ALBANIA SHA e cila zotëron 100 për qind të pjesëve të kapitalit të saj.

Me vendimin e datës 26 Qershor 2003, të Mbledhjes së Ortakut te Vetem, shoqerise GLOBAL PETROLEUM ALBANIA SHA, eshte marre vendimi per:

- Ndryshimin e selisë së shoqërisë ELDA PETROLEUM ALBANIA SHPK. Selia e re e shoqërisë është në adresën: Rruga e Kavajës, Nr. 59, Tirana Tower, kati IV, Tiranë, Shqipëri.

Më datë 29 gusht 2001 Ortaku i Vetëm i shoqërisë ELDA PETROLEUM ALBANIA SHPK vendosi zmadhimin e kapitalit te shoqërisë me një shumë totale prej USD 2,440,000 (dymilionëekatërqind edyzetëmijë) që i korrespondon shuma në Lekë 350,811,000 (treqindepesëdhjetëmilionë etetëqindenjëmbëdhjetëmijë), nga të cilat janë shlyer vetëm USD 700,000 (shtatëqindmijë) që i korrespondojnë shumës në Lekë 100,642,500 (njëqindmilionëegjashtëqindedyzetedymijëepesëqind).

Me vendimin e datës 12 shtator 2003, të Mbledhjes së Ortakut të Vetëm, shoqërisë GLOBAL PETROLEUM ALBANIA SHA, është marrë vendimi për:

- Përfundimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë duke shlyer shumën e mbetur prej Lekë 250,165,000.00 (dyqindepesëdhjetëmilionëenjëqindegjashtëdhjetëepesëmije) sipas Vërtetimeve Bankare lëshuar nga Banka e Tiranës SHA dhe Alpha Bank, Tirana Branch respektivisht në datë 10 korrik dhe 8 korrik 2003.

Me shlyerjen e plotë të zmadhimit të kapitalit, kapitali themeltar i shoqërisë ELDA PETROLEUM ALBANIA SHPK arrin vlerën në totale prej Lekë 363,003,718.00 (treqindegjashtëdhjetëetremilionetre mijëeshtatëqindetetëmbëdhjetë) nga të cilat 12,092,718.00 Lekë (dymbëdhjetëmilionenëntëdhjetëedy mijëeshtatëqindetetëmbëdhjetë) janë kontribute në natyrë kurse 350,911,000.00 Lekë (treqind e pesëdhjetëmilionenëntëqindenjëmbëdhjetëmijë) janë kontribute në para (dhurim nga të palët e treta, që është GOBAL SHPK).

## PËR KËTO ARSYE:

Pas shqyrtimit të kërkesës, e cmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare",

**VENDOSA:**

- Pranimin e Kërkesës;

- Depozitimin e Vendimeve të datës 26 Qershor 2003 dhe 12 shtator 2003, të Mbledhjes së Ortakut të Vetëm, shoqërisë GLOBAL PETROLEUM ALBANIA SHA, sipas të cilëve:

    1) Selia e re e shoqërisë ELDA PETROLEUM ALBANIA SHPK është në adresën: Rruga e Kavajës, Nr. 59, Tirana Tower, kati IV, Tiranë, Shqipëri.

    2) Pas zmadhimit, kapitali themeltar i shoqërisë ELDA PETROLEUM ALBANIA SHPK arrin vlerën në totale prej Lekë 363,003,718.00 (treqindegjashtëdhjetëetremilionetremijëeshtatë qindetetëmbëdhjetë) nga të cilat 12,092,718.00 Lekë (dymbëdhjetëmilionenëntëdhjetëedy mijëeshtatëqindetetëmbëdhjetë) janë kontribute në natyrë kurse 350,911,000.00 Lekë (treqind e pesëdhjetëmilionenëntëqindenjëmbëdhjetëmijë) janë kontribute në para (dhurim nga të palët e treta, që është GOBAL SHPK).

- Urdhërohet zyra e Regjistrit Tregtar të bëjë pasqyrimin e ndryshimeve në skedën e shoqërisë.

Dt. 25.09.03

GJYQTARE